



BASHKIA KORÇË

BUXHETI VJETOR 2018 BASHKIA KORÇË

NËNTOR 2017



BASHKIA KORÇË

Korça, qyteti i serenatave, qyteti i dashurisë, qyteti i artit, qyteti i birrës, Parisi i vogël, e po të kërkosh, gjen plot epitete të tjera që cilësojnë jo vetëm vlerat e saj, por edhe karakteristikat se përse duhet vizituar ky qytet i qeshur e plot jetë, që të fton në çdo stinë të vizitosh rrugët karakteristike, të mësosh për kulturën dhe historinë e tij, të kuptosh arsyen e prejardhjes së shumë atdhetarëve që sot mbushin faqet e historisë së kombit.

Korça, një nga qendrat qytetare më të rëndësishme të Shqipërisë me potenciale sociale, ekonomike, kulturore, arsimore e historike dhe popullsi vitale, përbën një nga vatrat kryesore të trashëgimisë kulturore ndër shekuj.

Korça, vendi ku gërshetohen kaq natyrshëm tradicionalja me modernen dhe ku ndërgjegjësimi qytetar për rëndësinë e turizmit si një faktor kryesor në zhvillimin ekonomik po rritet në paralelizëm me investimet në infrastrukturë, arsim dhe kulturë.



Për Korçën mund të flasësh gjatë, por për të zbuluar magjinë, ëmbëlsinë, dinamizmin, ritmin e vërtetë të këtij qyteti, duhet patjetër ta vizitoni atë!



BASHKIA KORÇË



Korça

Qendër rajonale me rëndësi kombëtare, me një ekonomi konkurruese, sipërmarrje dinamike, bujqësi e turizëm të zhvilluar, e fokusuar tek inovacioni duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për mjedisin. Qyteti i Korçës konsiderohet një qendër urbane e rëndësisë kombëtare dhe një prej kryeqendrave të Shqipërisë.

Të dhënat e popullsisë sipas Gjendjes Civile

Popullsia (total) 129,805

Qyteti i Korçës 86,693 banorë

Zona Urbane 67%

Zona Rurale 33%

Qyteti i Korçës është një qendër kryesore urbane e pjesës juglindore të Shqipërisë përse i përket madhësisë, popullsisë, administrimit, aktiviteteve ekonomike dhe kulturore. Qyteti është vendi ku ofrohet një numër i madh shërbimesh, aktiviteteve dhe lehtësirash që janë të lidhura jo vetëm me qytetin por edhe në pjesë të tjera të rajonit. Këtu përfshihen: shërbimet publike dhe administrative (Universitet, Spitali Rajonal, Gjykata e Apelit, Zyrat e Qarkut, Zyrat e Shërbimeve Publike, etj), aktivitete ekonomike (aktivitete industriale dhe të shitjes me shumicë, pazari, bankat, aktivitete biznesi të mesme dhe të vogla); institucione kulturore (si: muzeume, biblioteka); disa aktivitete dhe ekspozita rajonale (karnavalet, Festa e Birrës, etj).



BASHKIA KORÇË

Qyteti i Korçës në vetvete është një vend tërheqës turistik, duke ofruar një imazh të veçantë dhe identitet urban, si edhe shumë asete kulturore, siç janë pazari i qytetit, një ansambël i ndërtuar në shekullin e 19të, dhe disa muzeume.

Pikat Strategjike të Bashkisë Korçë janë:

1. Turizmi
2. Industria
3. Bujqësia

Fushat me interes për bashkëpunim janë në:

1. Arsim
2. Kulturë
3. Turizëm
4. Bujqësi
5. Pyjet
6. Ujrat



BASHKIA KORÇË

Përmbajtja e buxhetit vjetor 2018 dhe PBA 2018-2020

1. Hyrje	7
2. Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore	8
3. Objektivat kryesorë për buxhetin vendor të vitit 2018	8
4. Të ardhurat e veta të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	9
5. Transfertat nga buxheti i shtetit	48
5.1. Transferta e pakushtëzuar 2018.....	48
5.2. Transferta të kushtëzuara	49
5.3. Transfertat specifike	49
5.4. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	50
5.5. Dokumentacioni bazë:.....	51
5.6. Dokumentacioni shoqërues:	55
7. Projektet 2018.....	67
8. Huamarrja vendore 2018	88
9. Shërbimet publike.....	91
9.1. Shërbimi i pastrimit të qytetit.....	91
9.2. Shërbimi i transportit qytetës	92
9.3. Mirëmbajtja e varrezave publike dhe ato të dëshmorëve	92
• Kontributi për Qarkun.....	93
• Emergjencia civile.....	93
• Fondi rezervë dhe ai i kontingjencës	94
10. Transfertat 2018	94
10.1. Transfertat tek organizatat	95
10.2. Transferta tek individët.....	96
11. Transfertat specifike 2018.....	96
11.1. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.....	96
11.2. Administrimi i pyjeve	97
11.3. Arsimi parashkollor	98
11.4. Arsimi parauniversitar	98
11.5. Konviktet e arsimit parauniversitar	98
11.6. Ujitja dhe kullimi.....	99
11.7. Rrugët rurale	100



BASHKIA KORÇË

12.	Shpenzimet kapitale për vitin 2018.....	100
13.	Buxheti i Institucioneve të Varësisë për vitin 2018	108
13.1.	Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes	108
13.2.	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.....	122
13.3.	Klubi shumësportësh	128
13.4.	Klubi i Futbollit	133
13.5.	Qendra e Artit dhe Kulturës.....	134
13.6.	Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social (NJMBQS)	137
13.7.	Qendra Ditore e Zhvillimit	138
13.8.	Qendra Rezidenciale e Zhvillimit.....	138
13.9.	Shtëpia e Foshnjës	139
14.	Planifikimi i Buxhetit të Bashkisë 2019-2020	140
15.	Tabelat përmbledhëse dhe grafikët	143



BASHKIA KORÇË

1. Hyrje

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Bashkia harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj, pa defiçit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Buxheti është dokumenti që përmbledh tërësinë e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve, i miratuar nga KB e NJQV. Përkufizimi i buxhetit nuk kufizohet vetëm me përmbledhjen e shifrave dhe treguesve financiarë, por gjithashtu ka në përmbajtjen e tij karakteristikat e mëposhtme:

- **Dokument bazë i politikave**, planifikimit dhe kontrollit;
- **Kontratë** ndërmjet qytetarëve dhe të zgjedhurve vendorë;
- **Mjet komunikimi** me komunitetin dhe grupet e interesit;
- **Udhërrëfyes** drejt përmbushjes së objektivave;
- **Optimalizon** përdorimin e burimeve financiare në dispozicion;
- **Promovon** pjesëmarrjen e grupeve të interesit në qeverisje;
- **Mjet për matjen e arritjeve** kundrejt objektivave apo premtimeve.

1. Kuadri ligjor

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8/2012 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA-së”;
- Udhëzimi nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;
- Ligje dhe akte nënligjore të tjera.



BASHKIA KORÇË

2. Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore

Në menaxhimin e financave vendore, gjejnë zbatim parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të përmendura si më poshtë vijon:

- a) Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme.
- b) Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë financimin e prioriteteve strategjike të njësisë, në përputhje me politikat sektoriale e ndërsektoriale kombëtare dhe me nevojat e komunitetit, të cilit i shërbejnë.
- c) Programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.
- d) Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të ulin nivelin e taksave apo të tarifave vendore në buxhetin e vitit të fundit të mandatit të tyre, me përjashtim të rasteve kur ekziston një plan i detajuar ndër vite, i cili është miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.
- e) Me qëllim përdorimin me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në realizimin e përgjegjësisë të tyre, përfshirë konsultimin dhe koordinimin e prioriteteve strategjike.

3. Objektivat kryesorë për buxhetin vendor të vitit 2018

- 3.1.** Rritja e autonomisë fiskale.
- 3.2.** Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore të NJQV-ve për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve.
- 3.3.** Përmirësimi i qëndrueshmërisë, thjeshtësisë dhe barazisë në sistemin e transfertave, së bashku me rritjen e transparencës.
- 3.4.** Përmirësimi i sistemit të administrimit të financave publike në nivel vendor.
- 3.5.** Përmirësimi i procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit.



BASHKIA KORÇË

- 3.6. Financime të integruara sipas instrumentit të Politikës së Zhvillimit Rajonal, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në shpërndarje, si dhe bashkërendim me objektivat kombëtarë.
- 3.7. Konsolidimi i funksioneve të reja të transferuara në njësitë e qeverisjes vendore.

4. Të ardhurat e veta të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

4.1. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të administrojnë taksat vendore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Taksat vendore mund të klasifikohen sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
 - b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
 - c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;
 - d) taksa e tabelës;
 - e) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
 - f) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;
 - g) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;
 - h) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.



BASHKIA KORÇË

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2018

Planifikimi i të ardhurave për Bashkinë e Korçës për vitin 2018 është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave dhe tarifave, informacioni i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite, si dhe politikat e përcaktuara në periudhën në vijim. Në tabelën e mëposhtme ka informacion për të ardhurat e realizuara në vitin 2016, planin për vitin 2017, realizimin 10-mujor të vitit 2017, realizimin e pritshëm të vitit 2017 dhe planifikimin për vitin 2018. Në vitin 2018 të ardhurat parashikohen të jenë 961,223,890 lekë. krahasuar me planin e vitit 2017, të ardhurat nga burimet e veta për vitin 2018 parashikohen me një rritje prej 20,17 % ose 161,359,619 lekë më shumë. Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme, që janë të lidhura ngushtë me masat që priten të ndërmerren nga institucionet e ndryshme në bashkëpunim me strukturat e Bashkisë, por edhe jashtë saj për realizimin e parashikimeve të të ardhurave. Parashikimi i të ardhurave për vitin 2018 reflekton dhe ndryshimet në paketën fiskale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve.

Tabela 1: Planifikimi i të ardhurave për vitin 2018

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Viti 2016	Plani 2017	Fakt 10 m.'17	I pritshëm'17	Viti 2018
1	Taksë mbi ndërtesën	120,053,537	137,000,000	90,830,971	103,830,971	140,082,000
2	Taksë mbi truallin	4,709,608	7,000,000	5,237,159	5,937,159	7,500,000
3	Taksë mbi tokën bujqësore	22,450,806	36,500,000	12,407,781	18,107,781	37,230,000
4	Tatim shitjeje pasuri e paluajtshme	4,412,297	9,000,000	7,287,293	8,087,293	13,000,000
5	Taksë regjistrimi e përvitshme (automjete)	23,195,018	30,000,000	19,404,981	23,604,981	42,500,000
6	Taksë vendore B.V	11,870,476	40,000,000	6,572,333	7,092,333	32,200,000
7	Taksë për ndërtimet e reja	64,598,635	180,000,000	56,710,465	68,110,465	230,000,000
8	Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet	8,218,906	20,000,000	11,538,046	13,038,046	37,000,000
9	Taksë fjetje në hotel	3,191,494	3,900,000	2,982,523	3,882,523	4,200,000
10	Taksë tabelle	16,169,736	28,000,000	12,932,453	14,522,453	17,500,000
11	Taksë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	1,884,000	3,200,000	846	846	1,800,000
12	Taksë regjistrimi e përvitshme (biznesi)	1,823,500	2,000,000	150,000	190,000	0
13	Taksë ndik.infrastrukturë Ministria e Energjisë	1,804,439	0	8,286,781	8,286,781	12,200,000
14	Renta minerare	0	0	55,219	58,219	100,000



BASHKIA KORÇË

15	Tarifë regjistrimi për leje transporti	1,235,530	2,000,000	2,232,270	2,347,270	3,700,000
16	Tarifë therrje bagëti	571,200	700,000	584,250	744,250	1,000,000
17	Tarifë mur perimetral	400,438	700,000	531,542	652,782	1,450,000
18	Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	4,145,700	4,500,000	3,068,320	3,067,320	1,900,000
19	Tarifë pastrimi	109,957,985	117,000,000	99,242,142	116,242,142	165,000,000
20	Tarifë ndriçimi	36,317,435	39,955,000	31,911,166	36,311,166	41,000,000
21	Tarifë gjelbërimi	22,321,664	26,000,000	21,263,209	24,060,089	28,300,000
22	Tarifë mirëmbajtje varreza publike	10,597,898	17,000,000	10,348,193	12,748,193	16,150,000
23	Tarifë zënie hapësire publike	8,315,367	8,000,000	7,241,573	8,571,573	17,800,000
24	Tarifë parkimi	16,475,497	21,000,000	14,169,401	17,269,701	24,000,000
25	Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata+ UKKO+ DIV.TREG	10,999,655	16,000,000	9,720,028	10,420,028	14,700,000
26	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	583,800	50,000	119,700	135,700	500,000
27	Miraim projekt	297,500	500,000	66,500	116,500	300,000
28	Shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruara	0	90,000	0	0	250,000
29	Shërbime zjarrfikëse në bashki fqinje	0	300,000	0	0	300,000
30	Marrje me qera pylli+ qera për kullota	619,450	4,800,000	25,986,120	25,986,120	10,900,000
31	Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe heqja e materialit drusor	8,761,441	3,000,000	2,488,686	3,000,686	5,000,000
32	Vërtetime transporti	0	50,000	75,000	75,000	100,000
33	Prodhimet e dyta medicinale	0	100,000	182,900	482,900	300,000
34	Shitje Dokumenta ankandi	0	0	1,000	5,000	1,000
35	Gjoha policia bashkiake	1,095,000	1,000,000	1,102,000	1,402,000	2,000,000
36	Gjoha të biznesit të vogël	6,293,881	5,500,000	4,153,272	5,403,272	7,500,917
37	Gjoha inspektoriatit i ndërtimit	900,000	2,000,000	650,000	1,150,000	3,600,000
38	Gjoha të drejtorisë së kontrollit të territorit	656,100	1,000,000	466,250	616,250	1,500,000
39	Gjoha të drejtorisë së te ardhurave	0	0	0	0	300,000
40	Qera objekti,Qera Trualli,Qera T.bujqësore	3,668,608	14,620,471	1,629,274	2,309,274	19,920,000
41	Tarifë për dhënie e treguesve të zhvillimit	287,000	700,000	400,000	500,000	1,200,000
42	Tarife për leje ndërtimi	0	0	0	0	450,000
43	Tarifë servituti	1,238,474	2,000,000	952,910	1,112,910	2,000,000
44	Të ardhura nga qiratë, banesa	6,895,065	6,876,000	5,818,221	6,958,221	6,962,400



BASHKIA KORÇË


	sociale					
45	Qera nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave	3,177,200	5,272,800	2,609,619	3,129,619	5,377,573
46	Kamatë vonesa(qira objekti)	196,988	0	349,043	427,043	500,000
47	Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore	0	0	0	0	1,500,000
48	Tarifë uji	2,560,664	2,550,000	158,162	158,162	450,000
	TOTALI	542,951,991	799,864,271	481,917,601	560,153,021	961,223,890

Nëse i analizon realizimet e shumë prej zërave kanë ardhur me rritje nga viti në vit duke pasqyruar një përmirësim të dukshëm në administrimin dhe mbjedhjen e të ardhurave, rritjen e kapaciteteve, rritjen e transparencës, fuqizimin e nivelit të bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës midis institucioneve. Gjithashtu në realizimet e taksave apo tarifave që po paraqitim më poshtë ndikim kanë pasur dhe ndryshimet e herëpashershme të legjislacionit.

Tabela 2: Të ardhura ndër vite

	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Të ardhura ndër vite	542,951,991	560,153,021	961,223,890

Paraqitja grafike 1: Të ardhura ndër vite





BASHKIA KORÇË

Gjithashtu më poshtë po pasqyrojmë në mënyrë analitike dhe grafike realizimin e të ardhurave për vitet 2016 – 2017 (i pritshëm) si dhe planifikimin për vitin 2018 për çdo taksë dhe tarifë:

1. Taksa mbi ndërtesën

Tabela 3: Taksa mbi ndërtesën

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tatim mbi ndërtesën	120,053,537	103,830,971	140,082,000

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme përbëhet nga taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin dhe taksa mbi tokën bujqësore.


Taksa mbi ndërtesën: Baza e kësaj takse është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Taksa mbi ndërtesën për vitin 2018 planifikohet të jetë në vlerën 140,082,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet në vlerën 82,605,071 lekë prej 2,972 ndërtesash që shfrytëzohen nga subjektet e biznesit të vogël, subjektet e biznesit të madh, o.f.j apo institucione në Bashkinë Korçë me një sipërfaqe prej 399,128 m² (282,768 m² në njësinë administrative Korçë konkretisht: 54,777 m² sipërfaqe për prodhim, 196,940 m² sipërfaqe për tregëti dhe shërbime, 31,051 m² sipërfaqe për ndërtesa të tjera dhe 116,360 m² në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë konkretisht: 35,082 m² sipërfaqe për prodhim, 69,784 m² sipërfaqe për tregëti dhe shërbime, 11,494 m² sipërfaqe për ndërtesa të tjera), nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën 28,373,908 lekë prej 27,174 ndërtesash që shfrytëzohen për banim (13,755 shtëpi banimi para vitit 1993 me sipërfaqe 1,392,472 m², 6,597 shtëpi banimi mbas vitit 1993 me sipërfaqe 862,999 m² në Njësinë Administrative Korçë dhe 6,822 familje të evidentuara deri më tani nga procesi i verifikimit që po vazhdon në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë) si dhe nga debitorët



BASHKIA KORÇË

familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet të arkëtohet në vlerën 29,102,720 lekë. Për analizim të sipërfaqeve të përmendura më lart në tabelën e mëposhtme po japim të detajuara sipërfaqet e ndërtesave që shfrytëzohen për banim sipas vitit të ndërtimit dhe sipërfaqet e ndërtesave që shfrytëzohen për aktivitet biznesi sipas kategorive të mëposhtme:

Paraqitja grafike 2: Taksa mbi ndërtesën (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



2. Taksa mbi truallin

Tabela 4: Taksa mbi truallin

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksë Trualli	4,709,608	5,937,159	7,500,000


Truall është një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të. Në këtë kategori do të bëjë pjesë e gjithë sipërfaqja jashtë ndërtesës në funksion të saj. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në hektar, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumentacionit që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë zyrave të Bashkisë ku ndodhet prona. Pas vetëdeklarimit mund të bëhen verifikime në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlogaritet për të gjithë



BASHKIA KORÇË

periudhën. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Duke u nisur nga regjistrimet e bëra gjatë viteve 2016-2017 deri më tani rezulton një sipërfaqe trualli, e cila është në rritje të vazhdueshme si rezultat i studimit të të gjithë dosjeve të biznesit dhe për pasojë të zgjerimit të numrit të subjekteve që disponojnë këtë pronë. Për familjet detyrimi llogaritet sipas të dhënave që Bashkia Korçë disponon në bazën e të dhënave mbi të cilën është përlllogaritur dhe taksa e ndërtesës. Në lidhje me familjet e njësive administrative të tjera përveç njësisë administrative Korçë vazhdon puna në terren për inventarizimin dhe evidentimin e sipërfaqes truall që ata kanë në përdorim për banim. Taksa mbi truallin për vitin 2018 planifikohet të jetë në vlerën 7,500,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 298 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh me një sipërfaqe prej 310,652 m² të inventarizuara deri më tani në vlerën 5,591,736 lekë, nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën 370,972 lekë prej 883,267 m² sipërfaqe trualli për banim të 3,672 familjeve të inventarizuara deri më tani si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 1,537,614 lekë.

Paraqitja grafike 3: Taksë trualli (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



3. Taksa mbi tokën bujqësore

Tabela 5: Taksa mbi tokën bujqësore


Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksa mbi tokën bujqësore	22,450,806	18,107,781	37,230,000



BASHKIA KORÇË

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksa paguesit. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentacionit që e vërtetojnë atë. Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2018 është planifikuar 37,230,000 lekë prej 10,933 pronarësh apo poseduesish të saj me një sipërfaqe prej 12,498 ha, referuar këtu informacionit që ne disponojmë në lidhje me sipërfaqet e tokës bujqësore, kategorive të tyre si dhe duke përfshirë debitorët e krijuar të cilët nuk e kanë paguar këtë taksë gjatë vitit 2017 dhe në vitet e mëparëshme. Gjithashtu po vazhdon puna në terren për evidentim dhe inventarizimin e numrit të pronarëve apo poseduesve të tokës bujqësore, por dhe të siperfaqeve të tyre mbas gjëndjes faktike që ata disponojnë.

Paraqitja grafike 4: Taksa mbi tokën bujqësore (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



4. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Tabela 6: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	4,412,297	8,087,293	13,000,000


Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme dhe vendoset për të gjitha pasuritë nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Planifikimi për vitin 2018



BASHKIA KORÇË

do të jetë 13,000,000 lekë, duke ju referuar parashikimit të bërë nga Z.V.R.P.P-Korçë, e cila në rolin e agjentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor.

Paraqitja grafike 5: Taksë mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



5. Taksë e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor

Tabela 7: Taksë e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksë e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	23,195,018	23,604,981	42,500,000


Bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë. Referuar pikës 3, të nenit 4 të ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor. Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit të transportit rrugor. Taksë e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitin 2018 është planifikuar



BASHKIA KORÇË

në vlerën 42,500,000 lekë, parashikim ky i bërë jo vetëm nga D.R.SH.T.R-Korçë, e cila në rolin e agjentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor, por edhe duke u bazuar në realizimin e viteve paraardhëse, ndryshimet e fundit ligjore si dhe në të dhënat e disponuara.

Paraqitja grafike 6: Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



6. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Tabela 8: Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	11,870,476	7,092,333	32,200,000


Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë, është 5% dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 lekë në vit. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2018 parashikohet të jetë 32,200,000 lekë. Siç dhe e kemi theksuar dhe më parë është një ndër taksat që është prekur ndjeshëm dhe shpesh nga ndryshimet në legjislacionin tatimor. Drejtoria Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar



BASHKIA KORÇË

mbi fitimin e biznesit të vogël. Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësite të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore. Ky zë planifikohet të realizohet në këtë vlerë nga subjektet që i nënshtrohen pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, nga subjektet debitore, të cilët nuk do e paguajnë tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël deri në fund të vitit 2017.

Paraqitja grafike 7: Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



7. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2018 planifikohet në vlerën 230,000,000 lekë. Krahasuar me planin e vitit 2017 ka një rritje prej 50,000,000 lekësh ose 27.7%. Ndikim në këtë planifikim ka dhe trendi në rritje i aplikimeve online për lejë ndërtimi. Theksojmë se plani i përgjithshëm vendor u miratua në shkurt të këtij viti dhe bazohet në vizionin tonë për Bashkinë e Korçës si qendër rajonale me rëndësi kombëtare, me një ekonomi konkurruese, sipërmarrje dinamike dhe bujqësi e turizëm të zhvilluar. Gjatë këtyre viteve Bashkia Korçë synon të ndërtojë të ardhmen e saj mbi trashëgiminë e pasur historike, kulturore dhe shoqërore. Edhe për vitin 2018 kjo taksë do të vazhdojë të llogaritet në kufijtë që ka të përcaktuara ligjërisht.



BASHKIA KORÇË


8. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Tabela 9: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	8,218,906	13,038,046	37,000,000

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2018 është planifikuar 37,000,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit duke u nisur nga të dhënat e vitit 2016 dhe të vitit 2017 të cilat u shoqëruan me një trend në rritje të dhënieve të lejeve të legalizimit krahasuar me vitet paraardhëse, gjë e cila parashikohet të vijojë dhe gjatë vitit 2018.

Paraqitja grafike 8: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



9. Taksa e fjetjes në hotel

Tabela 10: Taksa e fjetjes në hotel


Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksa e fjetjes në hotel	3,191,494	3,882,523	4,200,000



BASHKIA KORÇË

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj. Planifikimi i të ardhurave për vitin 2018 është bërë duke parashikuar kapacitetet, numrin e njësive dhe periudhat e shfytëzimit. Taksa e fjetjes në hotel për vitin 2018 planifikohet në vlerën 4,200,000 lekë, bazuar në realizimin e kësaj takse për vitin 2017, në rritjen e numrit të subjekteve që japin strehim kundrejt pagesës siç janë hotelet, motelet, bujtinat dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin administrativ të Bashkisë Korçë. Theksojmë se vetëm për periudhën janar – tetor 2017 numri i personave të akomoduar në hotelet, motelet, bujtinat dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim ka kapur shifrën e 50,726 persona. Aktualisht numërohen 64 subjekte me kapacitet akomodues prej 1,551 personash në natë, dhe vetëm për vitin 2017 janë hapur 18 subjekte që japin strehim kundrejt pagesës me kapacitet akomodues prej 224 persona në natë. Arkëtim gjatë vitit 2018 do të ketë dhe nga ato subjekte të cilat nuk do ta paguajnë këtë taksë brenda vitit 2017. Gjithashtu pritet që gjatë vitit 2018 të hyjnë në funksionim dhe 6 subjekte të cilët aktualisht janë duke investuar në këtë fushë. Planifikimi për vitin 2018 është 8.1% më shumë se realizimi i pritshëm për vitin 2017 ose 317,477 lekë më shumë dhe 31.5% më shumë se realizimi faktik i vitit 2016 ose 1,008,506 lekë më shumë.

Paraqitja grafike 9: Taksa fjetje në hotel (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)





BASHKIA KORÇË

10. Taksa e tabelës

Tabela 11: Taksa e tabelës

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksa e Tabelës	12,613,886	14,370,240	17,500,000

Bazuar në Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

Tabela për qëllime identifikimi, mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.

Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike dhe që përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve .

Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.


Taksa e tabelës për vitin 2018 është planifikuar të jetë 17,500,000 lekë, parashikim ky i cili bazohet në administrimin dhe pasurimin e të dhënave për numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim, numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese mbi 2m² dhe sipërfaqen e tyre si dhe numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë reklamuese dhe sipërfaqen e tyre të ndodhura në Bashkinë Korçë. Konkretisht kjo taksë planifikohet të arkëtohet nga 33 subjekte që kanë vendosur tabelë identifikuese mbi 2 m² me sipërfaqe totale prej 174.04 m², 73 subjekte që kanë vendosur tabelë reklamuese me sipërfaqë totale prej 289.69 m² dhe 14 subjekte që kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim. Gjithashtu po vazhdojnë procedurat për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet të cilat nuk e kanë paguar këtë taksë për vitet ushtrimore paraardhese vlerë e cila planifikohet të jetë 3,093,500 lekë. Mbas ndryshimeve ligjore të bëra për vitin 2016 në lidhje me kategorizimin e taksës së tabelës kanë përfituar nga lehtësitë



BASHKIA KORÇË

fiskale një numër mbi 200 subjektsh të cilat kanë vendosur tabelë identifikuese nën 2m² të cilët nuk e paguajnë këtë taksë.

Paraqitja grafike 10: Taksa e tabelës (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



11. Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore (telefon, energji, TV kabllor, internet)

Tabela 12: Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore


Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	1,884,000	846	1,800,000

Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore për vitin 2018 është planifikuar 1,800,000 lekë, parashikim ky i bazuar në të dhënat që ne disponojmë në lidhje me përllogaritjen e kësaj takse për detyrimet e prapambetura që subjektet i kanë Bashkisë Korçë. Vlen të theksohet që këto detyrime do të arkëtohen në fillim të vitit 2018, periudhë në të cilën skadon dhe garancia bankare që subjekti debitor ka vendosur për llogari të Bashkisë Korçë deri në përfundim të procedurës gjyqësore që po ndiqet nga ana jonë për arkëtimin e këtij detyrimi.



BASHKIA KORÇË

Paraqitja grafike 11: Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



12. Taksë regjistrimi biznesi

Tabela 13: Taksë regjistrimi biznesi

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksë regjistrim biznesi	1,823,500	190,000	0

Taksë regjistrim biznesi për vitin 2018 nuk do të planifikohet. Kjo taksë do të ketë arkëtime nga subjektet e biznesit të vogël dhe të madh të Bashkisë Korçë të cilët figurojnë debitore deri në datë 31.12.2015 pasi prej vitit 2016 falë lehtësive fiskale që Bashkia Korçë ndërmori ndaj biznesit kjo taksë u bë zero.

Shënim: Kjo taksë u pasqyrua në këtë material për të pasqyruar arkëtimet që kanë ndodhur përgjatë viteve 2016 dhe 2017.



BASHKIA KORÇË


13. Taksë ndikimi në infrastrukturë Ministria e Energjisë

Tabela 14: Taksë ndikimi në infrastrukturë Ministria e Energjisë

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Taksë ndik.infrastrukturë Ministria e Energjisë	1,804,439	8,286,781	12,200,000

Taksa e ndikimit në infrastrukturë Ministria e Energjisë për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 12,200,000 lekë, parashikim ky i bazuar në arkëtimet e viteve të mëparëshme, në nivelin e investimeve që kjo ministri po kryen për përmirësimin e infrastrukturës në rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike në vend. Planifikimi për vitin 2018 është 47.2 % më shumë së realizimi i pritshëm për vitin 2017 ose 3,913,219 lekë më shumë.

Paraqitja grafike 12: Taksë ndikimi në infrastrukturë Ministria e Energjisë (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)





BASHKIA KORÇË


14. Renta minerare

Tabela 15: Renta minerare

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Renta minerare	0	58,219	100,000

Taksa e rentës minerare arkëtohet në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare. Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Për vitin 2018 kjo taksë planifikohet të aktëtohet në vlerën 100,000 lekë.

Paraqitja grafike 13: Renta minerare (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



15. Tarifë regjistrimi për lejë transporti

Tabela 16: Tarifë regjistrimi për lejë transporti


Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë regjistrimi për lejë transporti	1,235,530	2,347,270	3,700,000



BASHKIA KORÇË

Tarifë regjistrimi për leje transporti për vitin 2018 është planifikuar 3,700,000 lekë. Për këtë planifikim referimi i është bërë ndryshimeve të fundit të legjislacionit aktual në fuqi në fushën e transportit, pasi një pjesë e mirë e liçencave për subjektet që operojnë në këtë fushë sipas udhëzimeve të Ministrit të Transportit janë dhënë me afat 1 vjeçar me qëllim përshtatjen sipas kërkesave të ligjit.

Paraqitja grafike 14: Tarifë rregjistrimi për leje transporti (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)





BASHKIA KORÇË


16. Tarifë therje bagëtie

Tabela 17: Tarifë therrje bagëtie

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë therje bagëtie	571,200	744,250	1,000,000

Tarifë therje bagëtie për vitin 2018 është planifikuar 1,000,000 lekë, parashikim ky i cili bazohet në realizimin e kësaj takse në vitet e mëparshme, realizimit të pritshëm për vitin 2017 si dhe në masat e mara për mbikqyrjen e sigurisë ushqimore, formalizimit të tregut, parandalimit të therjes së kafshëve në vende ilegale si dhe disiplinimit të therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit në të gjithë territorin e Bashkisë Korçë.

Paraqitja grafike 15: Tarifë therje bagëtie (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



17. Tarifë mur perimetral

Tabela 18: Tarifë mur perimetral


Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë mur perimetral	400,438	652,782	1,450,000

Tarifë mur perimetral për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 1,450,000 lekë.



BASHKIA KORÇË

Paraqitja grafike 16: Tarifë mur perimetral (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



18. Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit

Tabela 19: Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit


Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	4,145,700	3,968,320	1,900,000

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitin 2018 është parashikuar 1,900,000 lekë, parashikim ky i cili bazohet në numrin subjekteve dhe detyrimet që ata kanë ndaj Bashkisë, të cilat nuk mundën të arketoheshin brenda vitit ushtrimor por që me ndjekjen e procedurave ligjore nga ana jonë do të arketohen gjatë vitit 2018. Aktualisht janë 52 subjekte të cilat figurojnë debitore për këtë tarifë për periudha të ndryshme mujore të cilat do të jenë objekt i masave shtrënguese. Kjo tarifë për vitin 2018 u bë 0 nga Bashkia Korçë në kuadër të lehtësive fiskale që ndërmerr çdo vit për kategori të ndryshme biznesi.



BASHKIA KORÇË

Paraqitja grafike 17: Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



19. Tarifa e pastrimit

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifa e Pastrimit	109,957,985	116,242,142	165,000,000


Tarifës së pastrimit i nënshtrohen: çdo familje rezidente efektive, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Korçë. Nivelet, baza e tarifës, kategoritë, nënkategoritë janë kompetencë e plotë e Këshillit të Bashkisë. Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim. Tarifa e pastrimit për vitin 2018 planifikohet të jetë në vlerën 165,000,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 3,328 subjekte aktive efektive në total dhe konkretisht nga 2,624 subjekte të biznesit të vogël (2,267 subjekte biznes i vogël të njësisë administrative Korçë dhe 357 subjekte biznes i vogël të njësive të tjera administrative të Bashkisë Korçë) në vlerën 26,381,000 lekë (24,513,500 lekë nga subjektet e njësisë administrative Korçë dhe 1,867,500 lekë nga subjektet e njësive të tjera administrative të Bashkisë Korçë), nga 704 subjekte të biznesit të madh (639 subjekte biznes i madh të njësisë administrative Korçë dhe 65 subjekte biznes i madh të njësive të tjera administrative) në vlerën 37,095,000 lekë (32,930,000 lekë nga subjektet e njësisë administrative Korçë dhe 4,165,000 lekë nga subjektet e njësive të tjera administrative



BASHKIA KORÇË

të Bashkisë Korçë), nga 19,500 familje rezidente efektive të njësive administrative Korçë në vlerën 74,100,000 lekë, nga 8,117 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 12,175,500 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 15,258,754 lekë. Ky planifikim në këtë masë vjen dhe si rezultat i ndryshimit të tarifës së pastrimit për vitin 2018 si për familjet apo bizneset të cilët e përfitojnë këtë shërbim por dhe nga rritja e nivelit të arkëtimeve. Arkëtimet e pritshme të vitit 2017 janë 5.71% më shumë se realizimi i vitit 2016 ose 6,284,157 lekë më shumë.

Paraqitja grafike 18: Tarifa e pastrimit (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



20. Tarifë ndriçimi

Tabela 20: Tarifë ndriçimi

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë ndriçimi	36,317,435	36,311,166	41,000,000


Tarifës së ndriçimit i nënshtrohen çdo familje rezidente efektive, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Korçë. Nivelet, baza e tarifës, kategoritë, nënkategoritë janë kompetencë e plotë e Këshillit të Bashkisë. Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim.



BASHKIA KORÇË

Tarifë ndriçimi për vitin 2018 planifikohet të jetë në vlerën 41,000,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 3,328 subjekte aktive efektive në total dhe konkretisht nga 2,624 subjekte të biznesit të vogël (2,267 subjekte biznes i vogël të njësisë administrative Korçë dhe 357 subjekte biznes i vogël të njësive të tjera administrative të Bashkisë Korçë) në vlerën 11,295,900 lekë (10,905,900 lekë nga subjektet e njësisë administrative Korçë dhe 390,000 lekë nga subjektet e njësive të tjera administrative të Bashkisë Korçë), nga 704 subjekte të biznesit të madh (639 subjekte biznes i madh të njësisë administrative Korçë dhe 65 subjekte biznes i madh të njësive të tjera administrative) në vlerën 5,897,500 lekë (5,457,000 lekë nga subjektet e Njësisë Administrative Korçë dhe 440,500 lekë nga subjektet e Njësive të tjera Administrative të Bashkisë Korçë), nga 19,500 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 13,650,000 lekë, nga 8,117 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 4,058,500 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 6,084,077 lekë.

Paraqitja grafike 19: Tarifë ndriçimi (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



21. Tarifë gjelbërimi

Tabela 21: Tarifë gjelbërimi


Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë gjelbërimi	22,321,664	24,060,089	28,300,000



BASHKIA KORÇË

Tarifës së gjelbërimit i nënshtrohen çdo familje rezidente efektive, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Korçë (përfshirë këtu subjektet e biznesit të vogël dhe familjet rezidente efektive në njësitë administrative të Bashkisë Korçë me përjashtim të njësisë administrative Korçë). Nivelet, baza e tarifës, kategoritë, nënkategoritë janë kompetencë e plotë e Këshillit të Bashkisë. Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim. Tarifa e gjelbërimit për vitin 2018 planifikohet të jetë në vlerën 28,300,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 2,971 subjekte aktive efektive në total dhe konkretisht nga 2,267 subjekte të biznesit të vogël (2,267 subjekte biznes i vogël të njësisë administrative Korçë) në vlerën 9,004,700 lekë, nga 704 subjekte të biznesit të madh (639 subjekte biznes i madh të njësisë administrative Korçë dhe 65 subjekte biznes i madh të njësive të tjera administrative) në vlerën 2,994,500 lekë (2,648,000 lekë nga subjektet e njësive administrative Korçë dhe 346,500 lekë nga subjektet e njësive të tjera administrative të Bashkisë Korçë), nga 19,500 familje rezidente efektive të njësive administrative Korçë në vlerën 9,750,000 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 6,497,999 lekë. Arkëtimet e pritshme të vitit 2017 janë 7.78% më shumë se realizimi i vitit 2016 ose 1,738,425 lekë më shumë.

Paraqitja grafike 20: Tarifë gjelbërimi (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)





BASHKIA KORÇË


22. Tarifë mirëmbajtje varreza publike

Tabela 22: Tarifë mirëmbajtje varreza publike

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë mirëmbajtje varreza publike	10,597,898	12,748,193	16,150,000

Tarifës së mirëmbajtjes së varrezave publike i nënshtrohet çdo familje rezidente efektive. Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet të cilat kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim. Tarifë mirëmbajtje varreza publike për vitin 2018 është planifikuar 16,150,000. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 19,500 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 9,750,000 lekë, nga 8,117 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 4,058,500 lekë si dhe nga debitorët familjarë parashikohet në vlerën 2,319,918 lekë. Arkëtimet e pritshme të vitit 2017 janë 20.28% më shumë së realizimi i vitit 2016 ose 2,150,295 lekë më shumë.

Paraqitja grafike 21: Tarifë mirëmbajtje varreza publike (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)





BASHKIA KORÇË


23. Tarifë për zënies e hapësirave publike

Tabela 23: Tarifë për zënies e hapësirave publike

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë për zënie e hapësirave publike	7,491,437	8,571,573	17,800,000

Tarifë për zënie e hapësirave publike për vitin 2018 është planifikuar 17,800,000 lekë, bazuar në parashikimin e inspektorëve për sipërfaqet dhe zënie e hapësirës publike të cilat përdoren për qëllime të ndryshme siç janë zënie e hapësirave publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, etj, zënie e hapësirave publike për tregëtim në tregje publike të miratuara nga bashkia të artikujve ushqimore, fruta – perime, vezë, mish, peshk, bulmet, e.t.j, zënie e hapësirave publike për tregëtim tek inkubatori i biznesit (ish UMB) të artikujve industrial, zënie e hapësirave publike për organizim evente të ndryshme, panaire, zënie e hapësirave publike për tregëtim të artikujve industriale të artikujve ushqimore, fruta – perime, kantina, kënde lojrash etj. Ky planifikim vjen dhe si rezultat i ndryshimit të tarifës për zënie e hapësirave publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit për periudhën maj-shtator të vitit 2018 por dhe nga rritja e nivelit të arkëtimeve. Arkëtimet e pritshme të vitit 2017 janë 14.4% më shumë se realizimi i vitit 2016 ose 1,080,136 lekë më shumë.

Paraqitja grafike 22: Tarifë për zënie e hapësirave publike (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)





BASHKIA KORÇË


24. Tarifë parkimi

Tabela 24: Tarifë parkimi

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë Parkimi	16,475,497	17,269,401	24,000,000

Tarifë parkimi për vitin 2018 është planifikuar 24,000,000 lekë, planifikim ky i kryer bazuar në vend parkimet e rezervuara, në të ardhurat që mbledh agjenti i parkimit privat, në numrin e mjeteve të transportit që do të marrin leje transporti qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, leje transport malli për llogari të vet, leje transport malli për të tretë, leje transporti për kamiona me peshë mbi 3,5 ton, liçensat për mjetet taksi (1+4) dhe (1+8) si dhe nga debitorët e subjekteve të biznesit që do të paguajnë këtë taksë gjatë vitit 2018.

Paraqitja grafike 23: Tarifë parkimi (realizimi për vitin 2016, 2017 (i pritshëm) dhe planifikimi 2018)



25. Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata, dividendë etj.

Tabela 25: Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata, dividendë etj.


Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2016	2017 (i pritshëm)	2018
Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata, dividendë etj.	10,999,655	10,420,028	14,700,000



BASHKIA KORÇË

Festa e Birrës do të zhvillohet në datat 15-19 gusht 2018 në dy zona; tek fusha pranë stadiumit “Skënderbeu” dhe tek Pazari i Vjetër . Një nga festat më të rëndësishme të qytetit, e cila tashmë është kthyer në traditë. Promovimi i vlerave të kulinarisë, traditës dhe zakoneve të qytetit të Korçës, nën tingujt e muzikës më të mirë shqipëtare gjatë pesë netëve. Një dekor i personalizuar tek të dyja vendet do të krijojë një atmosferë shumë të bukur festive, duke



BASHKIA KORÇË

rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve në qytet si dhe ndikuar pozitivisht në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe kulturor.

Qëllimi: Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .

Rezultatet:

- ✓ Festa e birrës si një nga festat kryesore të qytetit do të krijojë një atmosferë festive në qytetin e Korçës për gjatë pesë netëve verore, duke tërhequr turistë të shumtë brenda dhe jashtë vendit, si dhe duke e kthyer qytetin e Korçës në një pikë atraktive për turistët.
- ✓ Impakt direkt dhe indirekt në rritjen të ardhurave të bizneseve të rajonit.

Kostoja totale: 1,980,000 Lekë

Titulli i projektit : “Pjesëmarrje në Panaire Kombëtare dhe Ndërkombëtare”

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë gjatë vitit 2018 do të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, që mund të organizohen nga institucione publike dhe private në Shqipëri ose jashtë saj dhe kanë në fokus promovimin e vlerave turistike të vendeve pjesëmarrëse. Pjesëmarrja e Bashkisë Korçë në aktivitete të tilla, rrit numrin e vizitorëve dhe investitorëve, shton kontaktet me investitorë të huaj, agjensi turistike etj, me të cilët Bashkia Korçë krijon mundësi bashkëpunimi në të ardhmen.

Qëllimi: Promovimi i vlerave turistike të Korçës, të cilat ndikojnë në zhvillimin rajonal.

Objektivat:

1. Zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit publiko-privat, me synim përmirësimin e jetesës së qytetarëve si dhe nxitjen e investimeve në qytet me fokus turizmin.
2. Gjallërimin e bizneseve vendase dhe të huaja.
3. Prezantimin e mundësive dhe ideve për zhvillimin e turizmit në qytetin e Korçës.

Rezultatet:

- ✓ Prezantimi i qytetit të Korçës si një destinacion turistik.
- ✓ Nxitja e investimeve në qytet dhe rritja e mundësisë për të investuar në Korçë.



BASHKIA KORÇË

- ✓ Prezantimi i ideve të bashkisë Korçë për zhvillimin e partneritetit publiko-privat.
- ✓ Tërheqja e investitorëve dhe turistëve vendas dhe të huaj

Kostoja totale: 200,000 Lekë

Titulli i projektit: “Festa e Lakrorit”

Kohëzgjatja: Korrik 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Projekti “Festa e Lakrorit 2018” do të zhvillohet edhe këtë vit në formën e një eventi që do të tërheqë vëmendjen dhe pjesëmarrjen e shumë vizitorëve, duke konsoliduar profilin festiv të kësaj tradite. Festa e Lakrorit do të zhvillohet në fshatin Polenë, të shtunën e fundit të muajit korrik me qëllim gjallërimin e jetës social kulturore si dhe nxitjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës.

Në këtë festë një ditore do të marrin pjesë amvisa nga fshati Polenë (me qëllim ruajtjen e traditës kulinare të zonës). Do të gatohen lakrorë, te cilët do të pihen në saç, në çast për të gjithë ata që duan të shijonë një prej gatimeve më të veçanta korçare. Lëngje frutash dhe ëmbëlsira do të shoqërojnë gatimet e përgatitura.

Aktiviteti do të shoqërohet me muzikë dhe valle tradicionale të zonës së Korçës, karnalet e famshme të Polenës si dhe serenatat Korçare duke bërë që festimet të zgjatën deri në orët e vona të mbrëmjes. Kjo festë është shndërruar tashmë në një traditë të përvitshme, që nuk sjell vetëm shije, por edhe argëtim për të gjithë qytetarët, si edhe vizitorët vendas dhe të huaj.

Qëllimi:

Promovimi i vlerave tradicionale të gastronomisë, nxitja e frekuentimit të zonave turistike përrreth qytetit dhe gjallërimi i jetës në njësitë administrative të Korçës.

Rezultatet:

- ✓ Rritja e frekuentimit të aktiviteteve në sezonin e verës.
- ✓ Organizimi i një aktiviteti ku do të reklamohen gatimet tradicionale të qytetit.
- ✓ Vendosija në qëndër të vëmendjes e fshatrave turistike për të nxjerrë dhe promovuar vlerat e tyre kulturore dhe historike.

Kostoja totale: 402,500 Lekë



BASHKIA KORÇË

Titulli i projektit: “ Festa e Mollës”

Kohëzgjatja: Fillim tetori 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë, në kuadër të programit “Korça, Shpirti i Traditës” me qëllim promovimin e produktit vendas (mollës) dhe gjallërimin e jetës kulturore dhe artistike të njësive administrative të Korçës do të organizojë edhe këtë vit në fshatin Dvoran të Korçës projektin « Festa e Mollës ». Festa e Mollës do të zhvillohet në dy ditë. Ditën e parë do të organizohet një panair tek Pazari i Vjetër, ndërsa ditën e dytë aktiviteti do të zhvillohet në dy faza. Faza e parë do të konsistojë në vjeljen e mollëve në ferma të fshatit Dvoran, me qëllim jo vetëm argëtimin por edhe njohjen me kulturën e mbjelljes të mollëve si dhe kujdesin për to. Kurse faza e dytë do të konsistojë në organizimin e një panairi mollësh në qëndër të fshatit (të llojeve të ndryshme) të prodhurara nga fermerët e zonës të Dvoranit të Korçës, si edhe nënproduktet e mollës si lëng mollë, liko, uthull molle etj.

Këtu do të marrin pjesë aktorë që operojnë në këtë fushë si psh. Shoqata e Prodhuesve të Mollës, Zvirinë, fermerë të Dvoranit etj. Një element i rëndësishëm do të jenë dhe tingujt e muzikës popullore shqiptare. Për më tepër, do të organizohen lojra dhe kënde vizatimi për fëmijët. Aktiviteti do të vazhdojë deri në orët e pasdites duke ju dhënë mundësi të gjithë qytetarëve dhe vizitorëve vendas e të huaj të shijojnë një fundjavë ndryshe në Korçë.

Qëllimi:

- Të ndikojë në zhvillimin e ekonomisë në mënyrë direkte dhe indirekte.
- Nxitja e zhvillimit ekonomik të Dvoranit, krijimi i strukturave të qëndrueshme për forcimin e mundësive kulturore të tij drejt fuqizimit ekonomik.
- Gjallërimin e jetës kulturore në fshatin Dvoran, duke tërhequr një numër të madh vizitorësh jo vetëm nga qyteti i Korçës por edhe nga qytete të tjera të Shqipërisë si dhe duke mos përjashtuar turistë të huaj.
- Promovimi i produktit vendas, mollës, si një produkt bio dhe marketingu i tij duke krijuar mundësi shitjeje apo duke krijuar treg bashkëpunimi me fermerë të tjerë nga zona të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë.



BASHKIA KORÇË

Rezultatet:

- ✓ Krijimi i një panairi ndër rajonal me produktet vendase si nje mundësi bashkëpunimi midis aktorëve që operojnë në këtë fushë.
- ✓ Gjallërimi i jetës social- kulturore në Dvoran.
- ✓ Promovimi i produktit vendas (mollës) dhe nënprodukteve te saj.
- ✓ Rritja e numrit të turistëve vendas dhe të huaj në këtë vend.
- ✓ Impakt direkt dhe indirekt në ekonominë lokale

Kostoja totale: 402,500 Lekë

Titulli i Projekti : “Strehëzë emergjente”

Kohëzgjatja: 12 muaj

Pershkrim i përgjithshëm i projektit:

Marrja me qera e një apartamenti, pagesa e ujit dhe energjisë elektrike. Ky apartament shërben si strehëz për rastet emergjente të dhunës në familje. Në bashkëpunim me partnerët bëhet plotësimi i nevojave të tyre në veshmbathje, ushqim dhe shërbim psiko-social.

Qellimi: Krijimi i një ambjenti familjar dhe të sigurt për viktimat e dhunës në familje në momentin emergjent që paraqiten.

Objektivat:

1. Marrja me qera e një apartamenti që do të shërbejë si strehëz emergjente.
2. Akomodimi i personave të dhunuar deri në kalim të emergjencës që paraqet rasti.
3. Sigurimi i shërbimeve të tjera të nevojshme që do të mundësohen nga një organizatë jo qeveritare.

Rezultatet:

Viktimat e dhunës në familje do të kenë një strehim të sigurt larg ambjentit të dhunshëm deri në momentin e akordimit të Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes ose Urdhërit të Mbrojtjes nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gjatë qëndrimit në strehëz të mbijetuarat e dhunës dhe fëmijët e tyre do të marrin shërbim psiko-social dhe mbulimin e nevojave të tyre në veshmbathje, shtresa për fjetje, ushqim, ngrohje ambjenti, ujë të ngrohtë, produkte higjeno- sanitare, enë kuzhine, shtretër të vegjël për fëmijë, ushqim i veçantë për grup-moshën 0-3 vjeç. Përfituesit kanë mundësi edhe për zbavitje, si p.sh lodra për fëmijë, televizor, radio etj.



BASHKIA KORÇË

Përfituesit duhet të kujdesen vetë për pastrimin e ambientit dhe gatimin nëse qëndrimi i tyre është për një afat më të gjatë se dy ditë, në rastin e Urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe 20 (njëzet) ditë deri në akordimin e Urdhërit të Mbrojtjes.

Vlera e projektit: Ky projekt ka shumë rëndësi në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Strehimi i tyre është një shërbim bazë në uljen e rrezikut për viktimën e dhunës në familje, që mund të rrezikojnë edhe humbjen e jetës.

Kosto buxheti Bashkia: 288,000 Lekë

Titulli i Projektit : Qendra ditore për fëmijë – Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë

Kohëzgjatja: 12 muaj

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Qendrat ditore të fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve të përditshme synojnë të risin mirëqënien e fëmijëve të grupeve të marxhinalizuara duke i aftësuar gjithashtu për jetën dhe jetën në komunitet.

Qëllimi: Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë

Objektivat: Të përmirësojë mirëqënien e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian përmes integritit social dhe reduktimit të varfërisë

Rezultatet: Rezultat 1–Fëmijët Romë / Egjiptiane regjistrohen në shkollën fillore dhe janë të monitoruar pas shkollës në tre qendrat ditore të fëmijëve.

Rezultat 2–Fëmijët Romë/Egjiptiane fitojnë më shumë besim në veteve nëpërmjet asistencës psikologjike, aktivitete sociale dhe iniciativa të tjera mbi barazinë gjinore.

Rezultat 3–Fëmijët romë /Egjiptiane kanë qasje në kujdesin shëndetësor dhe janë bërë të vetëdijshëm për çështjet në lidhje me shëndetin.

Rezultat 4–Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes i prindërve Romë&Egjiptiane është rritur nëpërmjet themelimit të Komitetit të Prindërve.

Rezultat 5–Kapacitetet arsimore të fëmijëve janë rritur nëpërmjet kurseve të anglishtes, kompjuterit dhe kurseve të qepjes si dhe kurseve të gjuhës shqipe dhënë nënave të tyre.

Rezultat 6–Shëndeti i 40 fëmijëve të kequshqyer është përmirësuar si rezultat i ushqimit të shëndetshëm dhe trajnimeve mujore të prindërve mbi këtë temë nga pediatri.

Rezultat 7–Si rezultat i lobimit mbështetja ndaj këtij grupi përfituesish është rritur.



BASHKIA KORÇË

Vlera e projektit: Qendrat ditore për fëmijët janë një aspekt i rëndësishëm i shërbimeve sociale të bashkisë, që rrisin mirëqënien e këtij target grupi.

Kosto buxheti Bashkia : 1,776,000 lekë

Titulli i Projektit : “Qendra Komunitare p r mosh n e tret ”

Kohëzgjatja: 12 muaj

Qëllimi: Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre.

Objektivat:

1. Ofrimi i një mjedisi çlodhës dhe mikëpritës për të moshuarit.
2. Ofrimi i shërbimeve të specializuara sociale nëpërmjet 3 kujdestarëve të qëndrave, punonjësve socialë dhe atyre animatorë.
3. Organizimi i aktiviteteve social-kulturore, argëtuese.
4. Përmirësimi i kushteve shëndetsore të frekuentuesve të qëndrave.
5. Ofrimi i shërbimeve të tjera të nevojshme për të moshuarit.

Rezultatet:

- ✓ Krijimi i një ambjenti sa më mikëpritës në Qendrat Komunitare.
- ✓ Zvogëlimi i fenomenit të braktisjes dhe vetmisë të Moshës së Tretë.
- ✓ Vazhdimësia e përmirësimit të shërbimeve socialë në qytetin e Korçës.

Vlera e projektit: Qendrat ditore për moshën e tretë përmirësojnë jetën sociale të këtij target grupi, duke rritur kështu edhe cilësinë e jetës së tyre të përditshme.

Kosto buxheti Bashkia: 2,484,000 Lekë



BASHKIA KORÇË

Titulli i projektit: “Dita Ndërkombëtare e gruas”

Data e zhvillimit: 8 Mars 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Madje në shtete të ndryshme kjo ditë festohet si festë kombëtare. Kjo ditë shërben jo vetëm për bashkimin e grave pa dallim feje, race, kulture, gjuhe dhe prejardhjeje, por edhe për të kujtuar përpjekjet për barazi, paqe, drejtësi dhe ndërtim në gati 9 dekada.

Qëllimi:

Në kuadër të kësaj dite, Bashkia Korçë është angazhuar të kryejë një sërë aktivitete, me qëllim sensibilizimin qytetar.

Rezultate:

- ✓ Sensibilizim qytetar.
- ✓ Mirënjohje ndaj përpjekjeve për barazi dhe drejtësi.
- ✓ Bashkim të grave pa dallime.

Kostoja totale: 105,000 Lekë

Titulli i projektit: “Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë”

Data e zhvillimit: 5 shtator 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Programi “**Qyteti Social**” u vjen në ndihmë shtresave në nevojë në ofrimin e shërbimeve dhe në dhënien e ndihmesave materiale me qëllim zbutjen e varfërisë dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme me karakter social dhe ekonomik. Ky program ka si përfitues shtresa komunitare si: të moshuarit, familjet e varfra dhe fëmijët jetimë. Me këtë iniciativë të re Bashkia do të mbështesë hapjen e një qendre për grumbullimin e veshjeve të mirëmbajtura, të përdorura, të cilat do t’ju shpërndahen familjeve të varfra në qytet duke “edukuar” në këtë mënyrë edhe qytetarët korçarë për të dhënë kontributin e tyre për shtresat në nevojë.

Qëllimi:

Bamirësia luan rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave dhe në përputhjen e qëllimit të zhvillimit.



BASHKIA KORÇË

Rezultate:

- ✓ Përmirësim i kushteve jetësore për shtresat në nevojë.
- ✓ Përfshirje të një numri të madh vullnetarësh në këtë iniciativë.
- ✓ Rritje e ndjenjës së vullnetarizmit dhe humanizmit.
- ✓ Dhurim tek njerëzit në nevojë.

Kostoja totale: 172,000 Lekë

Titulli i projektit: “Dita Ndërkombëtare e PAK”

Data e zhvillimit: 3 Dhjetor 2018

Përshkrimi i shkurtër i projektit:

Me rastin e 3 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, është menduar të zhvillohet takimi i Kryetarit të Bashkisë me përfaqësues të të gjitha institucioneve dhe OJF-ve që kanë për fokus aftësinë e kufizuar. Me rastin e kësaj dite, do të organizohet edhe një koncert nga Qendra Kulturore e Fëmijëve “Mihal Grameno”, Korçë. Realizimi i aktivitetit kulturor të përbashkët do të zhvillohet në datë 3 dhjetor. Në fund të aktivitetit, për të gjithë personat pjesëmarrës do të ofrohet një koktej.

Qëllimi: Integrimi social i personave me aftësi të kufizuar (PAK).

Objektivat: Gjithëpërfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuar në aktivitetet kulturore dhe në jetën e përditshme.

Rezultatet:

- ✓ Sensibilizimi i popullsisë për të mirëpritur personat me aftësi të kufizuar (PAK) në jetën e përditshme.
- ✓ Duke dëgjuar zërin e personave me aftësi të kufizuar (PAK), do të mund të gjejnë zgjidhje për pengesat e shumta që dalin përpara në rrugën e gjithëpërfshirjes së tyre.

Vlera e projektit: 116,620 Lekë



BASHKIA KORÇË

Titulli i projektit: “Dita pa makina”

Data e zhvillimit: 22 shtator 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

“Dita pa Makina” synon sensibilizimin e njerëzve që të shmangin të paktën për një ditë përdorimin e makinave të tyre, të cilat emetojnë lëndë të dëmshme në atmosferë, si dhe shërben si përpjekje për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit.

Dita pa makina organizohet në qytete të ndryshme në vende të ndryshme të botës në mënyra të ndryshme, por me qëllimin e përbashkët për të reduktuar numrin e automjeteve në qytet. Përfitimi i madh shoqëror është një ditë me sa më pak trafik, një ambient më të gjelbër dhe reduktim të varësisë nga karburanti. Sot dita pa makina përfshin përkrahje nga 1500 qytete në 40 vende të botës.

Qëllimi:

Synojmë sensibilizimin e çdo qytetari, institucioni publik apo privat për të ndërmarrë veprime në mbrojtje të mjedisit.

Rezultate:

- ✓ Të shmangim përdorimin e makinave duke përdorur më shumë biçikletat dhe duke bërë ecje në këmbë në zonat këmbësore.
- ✓ Në këtë ditë synojmë të jemi sa më miqësor me mjedisin

Kostoja totale: 327,500 Lekë

Titulli i projektit: “Dita e Shkopit të Bardhë”

Data e zhvillimit: Viti 2018

Përshkrimi i shkurtër i projektit:

Me rastin e “Ditës së Shkopit të Bardhë”, Bashkia Korçë do të organizojë një takim të Kryetarit të Bashkisë me Shoqatën e Personave me Aftësi të Kufizuar. Duke synuar mbështetjen dhe lehtësimin sadopak të orientimit të tyre, do të shpërndahen 50 shkopinj, të realizuar enkas për ta.

Qëllimi: Sensibilizimi i shoqërisë për mirëpritjen e Personave me Aftësi të Kufizuar Shikimi.

Objektivat:

1. Lehtësimi i orientimit të personave me aftësi të kufizuar shikimi në jetën e përditshme.



BASHKIA KORÇË

Rezultatet: Gjithëpërfshirja e personave me aftësi të kufizuar shikimi në jetën e përditshme të shoqërisë.

Vlera e projektit: 100,000 Lekë

Titulli i projektit: “Dita e autizmit”

Data e zhvillimit: 2 Prill 2018

Përshkrimi i shkurtër i projektit:

Me rastin e “Ditës së Autizmit” në datën 2 Prill, Bashkia Korçë me synim mbështetjen e kësaj kategorie të fëmijëve ndryshe, do t’ju vijë në ndihmë duke iu ofruar materiale të posaçme për këta persona. Materialet e nevojshme, të cilat do të çohen në ambientet e Shkollës Speciale do të ndihmojnë jo vetëm fëmijët autikë, dhe prindërit e tyre, por do të jenë një mbështetje e madhe për të lehtësuar edhe punën e edukatorëve të tyre.

Qëllimi: Nëpërmjet materialeve ndihmëse të afzuara, lehtësojmë punën për riaftësimin e fëmijëve autikë.

Objektivat: Lehtësimi i punës për riaftësimin e fëmijëve autikë.

Rezultatet:

Nëpërmjet materialeve ndihmëse të afzuara, bëhet e mundur lehtësimi i punës për riaftësimin e fëmijëve autikë.

Vlera e projektit: 131,199 Lekë

Titulli i projektit: “Dita e Jetimëve”

Data e zhvillimit: 20 Maj 2018

Përshkrimi i shkurtër i projektit:

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Jetimëve, në datën 20 Maj mendohet të zhvillohet një takim i Kryetarit të Bashkisë me të gjithë fëmijët jetimë të Bashkisë Korçë. Takimi do të mbyllet me një koktejl për të gjithë të pranishmit. Gjithashtu, në lidhje me këtë projekt është menduar që fëmijët e Shtëpisë së Foshnjës “Lulet e Vogla”, të çohen në një qendër argëtimi, ku do t’ju organizohet edhe një koktejl.

Qëllimi: Duke ju ndodhur pranë në ditën e tyre, me qëllim që t’ia u pakësojmë sadopak dhimbjen e shkaktuar nga mungesa prindërore.

Objektivat: T’ju qëndrojmë sa më pranë kësaj shtrese të shoqërisë në nevojë.



BASHKIA KORÇË

Rezultatet: Duke ju gjendur afër kësaj shtrese në nevojë të fëmijëve, njihemi më mirë me nevojat që ata kanë dhe mundohemi t'i eliminojmë ato.

Vlera e projektit: 157,620 Lekë

Titulli i Projektit : “Ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje”

Kohëzgjatja: Janar 2018 n vazhdim si

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Në Njësitë Administrative nuk ka struktura të mirëngritura për menaxhimin e rasteve në territorin e tyre. Kjo bën që personat që janë viktime të dhunës në familje, kryesisht gra dhe fëmijë, ta kenë të vështirë që të vetëm të dalin nga situata në të cilën ndodhen. Pranë këtyre njësive është e domosdoshme prania e një grupi multidisiplinar, i cili do të asistojë këta persona.

Ky projekt është projektuar për të përmirësuar shërbimet dhe për të forcuar mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës në familje, jo vetëm në nivel të bashkisë, por edhe në nivel njësie administrative. Shumica e Nj.A. nuk kanë ekip teknik të ngritur, por vetëm një person përgjegjës, i cili nuk e ka detyrë funksionale menaxhimin e rasteve të dhunës.

Popullata e Njësive Adminstrative duhet informuar, sepse ka mungesë informacioni. Menaxhimin e rastit pas referimit e bën Bashkia qendër.

Megjithëse numri i denoncimeve është në rritje, përsëri, duhet kryer një sensibilizimin i popullsisë në zonat rurale, me komunitetin parashkollor dhe atë të shkollave me qëllim që të kontribuojmë në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Qellimi: Sensibilizimi i komunitetit mbi fenomenin e dhunës në familje

Objektivat:

- Komuniteti i zonave rurale do të marrë informacion mbi fenomenin e dhunës në familje dhe pasojat negative që ai sjell.
- Do të marrë informacion të nevojshëm për mënyrën sesi mund të denoncohet dhuna.
- Do të informohet rreth shërbimeve që ofrohen dhe rëndësinë që ka denoncimi.

Rezultatet: Rritja e sensibilizimit të popullsisë në zonat rurale.

Vlera e projektit: Një aspekt shumë i rëndësishëm në luftimin e dhunës në familje është njohja e fenomenit dhe aspekteve negative të tij. Nga statistikat rezulton që komuniteti i



BASHKIA KORÇË

zonave rurale, kryesisht gra dhe vajza, ndonëse të dhunuara, nuk raportojnë për dhunën e ushtruar. Sensibilizimi është mjaft i rëndësishëm në mënyrë që të rritet denoncimi ndaj krimit të dhunës në familje në këto zona.

Kosto buxheti Bashkia: 136,900 Lekë

Titulli i projektit: “Broshura- Guida e Korçës”

Kohëzgjatja : Janar 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit :

Broshura –“Guida e Korçës” e planifikuar në buxhetin e vitit 2018 do të konsistojë në riprintimin e broshurës egzistuese duke promovuar vlerat e qytetit dhe atraksioneve turistike të tij. Realizimi i kësaj broshure-guidë për turizmin, do të ketë si qëllim prezantimin e turistëve vendas dhe të huaj Korçën si një destinacion të zhvilluar turistik. Kjo broshurë do të prodhohet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Do të përmbajë foto dhe informacion të rëndësishëm për turistët duke i informuar rreth zakoneve, kulturës, traditave, festave, panairëve, kulinarinë, fshatrave turistike (Voskopojë, Vithkuq, Dardhë dhe Boboshticë), bukurive natyrore, objekteve të kultit, muzeut të qytetit si dhe mënyrave për tu argëtuar apo kaluar kohën e lirë në qytet. Me këtë projekt do të printohen dhe dizajnohen mini broshura të veçanta për të kthyer vëmendjen tek fshatrat turistike Voskopojë, Vithkuq dhe Dardhë si dhe për të pasur një paketë turistike të plotë. Për të promovuar këtë komplet guidash do të krijohet një tryezë e rrumbullakët me aktorë që operojnë në fushën e turizmit, e cila do të shërbejë edhe për të nxjerrë problematikat dhe nevojat e turizmit në qytetin e Korçës.

Qëllimi:

- Promovimi i qytetit të Korçës dhe atraksioneve turistike (Voskopojë, Dardhë, Vithkuq, Boboshticë etj.)
- Informimi i plotë i vizitorëve vendas dhe të huaj lidhur me gjithçka që mund të gjejnë në Korçë.
- Evidentimi i problematikave në fushën e turizmit.



BASHKIA KORÇË

Rezultatet:

- ✓ Realizimi i një broshure me informacion të plotë në gjuhën shqipe dhe angleze, të shoqëruar me foto rreth atraksioneve turistike të rajonit të Korçës, fshatrave turistike përreth saj si dhe kontakte rreth shërbimeve turistike që ofrohen.
- ✓ Informimi i vizitorëve vendas dhe të huaj rreth atraksioneve turistike të këtij qyteti.
- ✓ Përdorimi i kësaj broshure për turizmin dhe përfaqësimin e qytetit në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kostoja totale: 850,000 Lekë

Titulli i projektit: “Libri i Serenatave”

Kohëzgjatja: Mars 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

“Libri i Serenatave” ka si qëllim promovimin e traditës muzikore të qytetit nëpërmjet regjistrimeve origjinale të seranatës korçare ndër vite. Serenata nisi rrugën e vet të zhvillimit si gjini e veçantë e muzikës së lehtë që në shekullin e XVIII. Serenatat e para janë luajtur me një nga veglat më të lashta muzikore të përdorura nga njeriu, me fyell. Këtij ju shtua më vonë edhe llahuta e më pas mandolina dhe kitara. Kjo gjini e muzikës së lehtë shpreh ngjyrimet e shpirtit njerëzor dhe të mjedisit ku ajo këndohet. Në atë ndihet, mbi të gjitha, brenga dhe malli bashkë me sinqeritetin e çiltër dhe ndjenjën e adhurimit të dashurisë. Serenata është një formë e shprehjes së lirë të frymëzimit. Originaliteti i seranatës korçare është i padiskutueshëm dhe ka të bëjë me rolin që ajo luajti në botën shpirtërore korçare. Serenata korçare, gjatë ekzistencës së saj afro 150-vjeçare, numëron shtatë breza serenatistësh. Serenata Korçare e ka merituar me kohë pavdekësinë e vet dhe këtë përkushtim modest. Janë vlerë e trashëguar e qytetit të Korçës dhe nëpërmjet këtij projekti kemi për qëllim promovimin cilësor të kësaj tradite kulturore.

Qëllimi:

Ky projekt ka për qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Korçës.

Rezultate:

- ✓ Ringjallja e traditës kulturore të qytetit.
- ✓ Promovimi i serenatave më të dëgjura.



BASHKIA KORÇË

- ✓ Edukimi i brezave të rinj me ndjenjën e trashëgimisë kulturore.

Kostoja totale: 370,000 Lekë

Titulli i projektit: “Parku me materiale të riciklueshme”

Kohëzgjatja: Viti 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Përfshirja e shumë aktorëve në këtë iniciativë rinore, krijon një ndërgjegjësim mbi mjedisin:

- Të rinjtë e shkollave do të krijojnë dhe zbatojnë idetë e tyre inovative, duke marrë pronësinë e suksesit të këtij projekti dhe eksperiencën për ta replikuar në mjedise të tjera.
- Të rinjtë e papunë dhe të trajnuar në Qendrën e Trajnimit Profesional, do të ndihmojnë në punimin me materialet e riciklueshme.
- Materialet e riciklueshme (banka dhe tavolina të vjetra, etj) do të ofrohen nga NSHMAÇ.

Forcimi i partneritetit midis aktorëve, do të çojë në promovimin e iniciativave të përbashkëta të zhvillimit lokal dhe rajonal, përmirësimin e mjedisit dhe shërbimeve në zonë.

Qëllimi:

Tu ofrojë të rinjve një zonë të sigurt të gjelbër që mbështetet në inovacionin dhe kreativitetin e tyre.

Rezultate:

- ✓ Të rinjtë e shkollave të mesme dhe Universitetit, rrisin informacionin, interesin dhe ndërgjegjesimin mbi çështjet mjedisore dhe ato të pjesëmarrjes qytetare në projekte komunitare.
- ✓ Vlerësimi i iniciativave dhe ideve inovative të të rinjve në zbatimin e projektit dhe bashkëpunimi i tyre me NJQV.
- ✓ Krijimi i një modeli të përfshirjes së të rinjve, i promovuar online, si një shembull për tu replikuar në Korçë dhe jo vetëm.

Kostoja totale: 109,000 Lekë

Titulli i projektit: “Dita Ndërkombëtare e Tokës”

Data e zhvillimit: 22 Prill 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:



BASHKIA KORÇË

Data 22 Prill, njihet në gjithë botën, si Dita Ndërkombëtare e Tokës. Kjo është një ditë që shërben për të dhënë alarmin për dëmet që njerëzimi i shkakton pyjeve, lumenjve, tokës dhe pasurive të tjera të natyrës. Qëllimi i kësaj dite është reflektimi dhe sensibilizimi për të ndaluar shkatërrimin e mëtejshëm të saj. Më 22 prill, në mbarë botën, dashamirës të mjedisit organizojnë një varg aktivitete për të mirën e mjedisit dhe të njeriut, si: aktivitete pastrimi, gjelbërimi, pyllëzimi, manifestime në formë protestash, ekspozita, koncerte, vizita, peticione, orë edukative me nxënës, konferenca shkencore lidhur me problemet mjedisore etj.

Qëllimi:

Në kuadër të kësaj dite, Bashkia Korçë është angazhuar të kryejë një sërë aktivitete, me qëllim sensibilizimin qytetar.

Rezultate:

- ✓ Sensibilizim qytetar.
- ✓ Ndërgjegjësim mbi ruajtjen dhe sigurinë e mjedisit.
- ✓ Angazhim i qytetarëve lidhur me dobinë e mjedisit.
- ✓ Angazhim dhe sensibilizim të nxënësve të shkollave.

Kostoja totale: 131,000 Lekë

Titulli i projektit: “Pikturat Murale”

Kohëzgjatja: Gjatë vitit 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

“Pikturat murale” vjen si një projekt i Njesisë Kreative për të disatin vit radhazi. Një karakteristikë dalluese e pikturës murale është se elementët arkitektonikë të një hapësirë të caktuar përfshihen në mënyrë harmonike në foto. Pikturat murale janë të rëndësishme për imazhin që përçojnë në sferën publike. Shpesh efektet vizuale janë një joshje për të tërhequr vëmendjen e publikut për çështjet sociale. Gjthashtu prania e madhe e pikturave murale shton përmirësimin estetik dhe mirëqënien e përgjithshme të banorëve.

Qëllimi:

Dekorim të fasadave të amortizura nga vitet për përmirësim të imazhit të qytetit si dhe sensibilizimin e qytetarëve në çështje sociale.

Rezultate:

- ✓ Angazhim i piktorëve të rinj të qytetit.



BASHKIA KORÇË

- ✓ Dekorim të fasadave të amortizura nga vitet.

Kostoja totale: 147,000 Lekë

Titulli i projektit: “Korça open air”

Kohëzgjatja: Fund dhjetori

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë do të organizojë gjatë muajit dhjetor 2018 aktivitetin “Korça Open Air”, në të cilën do të marrin pjesë parashutistë profesionistë nga Aeronautika Shqiptare, të cilët do të garojnë mes tyre duke organizuar fluturime të lira në qytetin e Korçës. Për të gjithë të apasionuarit pas sporteve në natyrë, do të zhvillohen fluturime dyshe me ndihmën e profesionistëve. Në përmbyllje të aktivitetit do të realizohet Ceremonia zyrtare e ndarjes së çmimeve për fituesit e aktivitetit “Korça Open Air 2018” .

Qëllimi: Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktiviteteve sportive në natyrë.

Objektivat:

1. Zhvillimi i aktiviteteve në natyrë me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e turizmit të aventurës.
2. Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj të apasionuar pas turizmit të aventurës.

Rezultatet:

- ✓ Realizimi i fluturimeve të lira nga ajri për të gjithë qytetarët, vizitorët vendas dhe të huaj.
- ✓ Kthimi i këtij aktiviteti sportiv në një aktivitet të përvitshëm, duke u kthyer në traditë.
- ✓ Nxitja e brezit të rinj për të frekuentuar aktivitetet që zhvillohen në natyrë.

Kostoja totale : 100,000 Lekë

Titulli i projektit: “Festivali i vjeshtës”

Kohëzgjatja : Shtator -Tetor 2018

Përshkrimi i shkurtër i projektit:

“Festivali i Vjeshtës” do të jetë një projekt tjetër që do të shtohet kalendarit të eventeve të Bashkisë Korçë, i cili do të konsistojë në një numër të madh aktivitetesh që do të ndodhin gjatë një muaji në këtë qytet. Gjatë periudhës shtator - tetor do të ketë mjaft aktivitete kulturore, artistike dhe tradicionale për të përçuar vlerat që ky qytet mbart si dhe mesazhin se



BASHKIA KORÇË

në Korçë festohet gjatë gjithë vitit. Bukuria e vjeshtës do të shoqërohet dhe me tingujt e muzikës shqiptare ku këngëtare të mirënjohur do të përformojnë tek skenat e Pazarit të Vjetër dhe Zonës Këmbësore.

Veçantia e këtij festivali do të jetë dhe dekori specifik dhe i personalizuar i ideuar dhe i realizuar me mjeshtëri nga stafi i bashkisë.

Do të publikohet një kalendar aktivitetesh me data dhe orare specifike për cdo aktivitet të projektit, i cili do të shpërndahet kudo për të tërhequr një numur të madh vizitorësh. Vend të rëndësishëm në projektin “Festivali i Vjeshtës “ do të zenë dhe fëmijët. Do të realizohen cdo të dielë aktivitete argëtuese për ta.

Qëllimi:

- Vazhdimësia e këtij eventi krahas eventeve të shumta të qytetit, të cilin synojmë ta kthejmë në traditë të përvitshme.
- Kthimi i aktivitetit në një atraksion turistik.
- Pasurimi i jetës social- kulturore të qytetarëve të Korçës.

Rezultatet:

- ✓ Gjallërimi i jetës kulturore artistike në qytet.
- ✓ Rritja e numrit të vizitorëve
- ✓ Rritja e të ardhurave të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (bare, restorante, hotele etj).
- ✓ Rritja e numrit të të rinjve si frekuentues të aktiviteteve të organizuara nga bashkia.

Kostoja totale: 550,500 Lekë

Titulli i projektit: “Idea Bombing”

Kohëzgjatja: Viti 2018

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Duke e vlerësuar si mjaft pozitive eksperiencën e Bashkisë Korçë me krijimin e një bërthame brenda këtij institucioni, i cili ka si qëllim zgjidhjen e problematikave në mënyrë inovative me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve, do të krijojë një konkurs për të përzgjedhur dhe thithur të gjitha idetë inovative që vijnë nga të rinjtë. Gjatë këtij konkursi, të rinjtë që do të bëhen pjesë do të kenë mundësi të japin zgjidhje, ide apo të ngrenë dhe problematika që realisht kërkojnë zgjidhje jo vetëm për qytetin e Korçës, por duke e shtrirë rrezën e



BASHKIA KORÇË

veprimet edhe në njësitë administrative. Në fund të konkursit tre praktikantët më të mirë do të futen në planet e implementimit të Bashkisë Korçë.

Qëllimi:

- Të rritet përfshirja e të rinjve në vendimarrje dhe zhvillim ekonomik, social dhe kulturor të qytetit.
- Të krijohet mundësi promovimi dhe shpaleshja e talentesh të reja të rinisë korçare.
- Të ndjehen të përfshirë dhe të motivuar për një të ardhme të mirë të vendit.

Rezultatet:

- ✓ Realizimi i konkursit dhe përzgjedhja e tre praktikantëve më të mirë.
- ✓ Thithja e ideve inovative nga të rinjtë.
- ✓ Krijimi i një databaze me të rinj të talentuar dhe aktive në jetën e qytetit.

Kostoja totale: 257,000 Lekë

Titulli i projektit: “Dita Ndërkombëtare e Moshës së Tretë”

Kohëzgjatja: Viti 2018

Përshkrimi i shkurtër i projektit:

Në kuadrin e ditës ndërkombëtare të të moshuarve, Bashkia e Korçës krahas shumë projekteve të tjera për këtë grupmoshë, do të realizojë në këtë ditë një sërë aktiviteteve për të treguar mbështetjen dhe përkrahjen ndaj kësaj shtrese. Gjatë projektit do të përcaktojmë personat e moshës së tretë të vetmuar në nevojë në qytet për të pasur një databazë të saktë. Sensibilizimi do të konsistojë në organizimin e një dreke për këta persona në nevojë. Në këtë menyrë, ju gjendemi më pranë duke dëgjuar problematikat e tyre.

Qëllimi:

T'i qëndrojmë sa më afër kësaj shtrese në nevojë, për t'i bërë ata që të ndjehen sa më mirë.

Objektivat:

T'ju gjendemi sa më pranë personave të moshës së tretë të vetmuar.

Rezultatet:

- ✓ Duke i qëndruar pranë kësaj shtrese në nevojë, largojmë ndjesinë e vetmisë të të moshuarve që ndodhen në kushte të vështira jetese.

Vlera e projektit: 78,000 Lekë



BASHKIA KORÇË

8. Huamarrja vendore 2018

Gjatë vitit 2018 është planifikuar shlyerja e kredisë (disbursimi i parë, disbursimi i dytë dhe i tretë) për kredinë e marrë tek **Pro Credit Bank**, e cila përbëhet nga pagesa e interesit dhe e principalit. Për vitin 2018 pagesa e interesit është në vlerën **1,700 mijë lekë** dhe pagesa e principalit është në vlerën **10,800 mijë lekë**.

Për shlyerjen e kredisë (disbursimi i parë, disbursimi i dytë dhe i tretë) për kredinë e marrë tek **Intesa Sanpaolo Bank** gjatë viteve 2014-2015, në bazë të planit të amortizimit të llogaritur, pagesat janë: pagesa e interesit në vlerën **7,800 mijë lekë** dhe pagesa e principalit **20,170 mijë lekë**.

Për vitin 2018 fondi i planifikuar për pagesën e transhit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të principalit, për kredinë e përfituar nga **CEB** për ndërtimin e banesave me kosto të ulët pagesa e principalit është **16,630 mijë lekë**.

Pra në total në buxhetin e Bashkisë për vitin 2018 pagesat e principalit sipas planeve të amortizimit janë në vlerën **47,600 mijë lekë** dhe pagesat e interesit sipas planeve të amortizimit janë në vlerën **9,500 mijë lekë** sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 60: Planet e amortizimit të kredisë (vlerat në 000/lekë)

Emërtimi	Principal	Interesi
ProCredit Bank	10,800	1,700
Intesa San Paolo Bank	20,170	7,800
Ministria e Financave	16,630	
Total	47,600	9,500

Intesa SanPaolo

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin tetor është 49,000,000 lekë.

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin dhjetor është 100,000,000 lekë.

Për vitin 2015 shuma e disbursuar në muajin mars është 50,000,000 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë është: principalin në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 13,202,258.95 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën shkurt 2015- tetor 2017 janë paguar principal 9,396,194.72 lekë dhe interes në vlerën 7,056,246.82 lekë.



BASHKIA KORÇË

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë është: principlali në vlerën 100,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 30,301,540.37 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën mars 2015- tetor 2017 janë paguar principlal 16,184,285.38 lekë dhe interes në vlerën 13,448,157.72 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë është: principlali në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 14,461,705.28 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Qershor 2015- Tetor 2017 janë paguar principlal 7,220,241.28 lekë dhe interes në vlerën 5,964,038.80 lekë.

Pro-Credit Bank

Për vitin 2010 shuma e disbursuar është 45,000,000 lekë.

Për vitin 2011 shuma e disbursuar është 23,800,000 lekë.

Për vitin 2012 shuma e disbursuar është 23,800,000 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë është: principlali në vlerën 45,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 18,455,039.67 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën tetor 2010- tetor 2017 janë paguar principlal në vlerën 29,382,649.69 lekë dhe interes në vlerën 17,302,258.68 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë është: principlali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 9,255,328.21 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim qershor 2011- tetor 2017 janë paguar principlal në vlerën 13,586,542.91 lekë dhe interes në vlerën 8,229,245.59 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë është: principlali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 8,318,796.56 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim Tetor 2012- Tetor 2017 janë paguar principlal në vlerën 10,634,433.31 lekë dhe interes në vlerën 6,675,016.06 lekë.

Përdorimi i huamarjes vendore (kredisë) për shpenzime kapitale është mbyllur gjatë vitit 2012.



BASHKIA KORÇË

Tabela 61: Ecuria dhe realizimi i investimeve financuar nga kredia për periudhën 2014-2017

ECURIA DHE REALIZIMI I INVESTIMEVE FINANCUAR NGA KREDIA PËR PERIUDHËN 2014-2017

Emertimi	Plan	Burimi i financimit 2014			Burimi i financimit 2015				Total vlera e likujdimit 2014-2017	Ecuria e punimeve 2014-2017	Fondi i mbetur
		Kredia disbursimi i parë 49,000,000		Total vlera e likujdimit	Kredia disbursimi i dytë 100,000,000		Disbursimi i tretë 50,000,000				
		Likuidimi '14	Likuidimi '15		Likuidimi '15	Likuidimi '15	Likuidimi '16	Likujdimi '17			
Rikonstruksion i shkallëve dhe Varrezave të Dëshmorëve	22,306,740.00	22,306,740.00	0.00	22,306,740.00	0.00	0.00	0.00	0.00	22,306,740.00	Punimet kane perfunduar	-
Rikonstruksion i rrugëve në lagjen nr. 6 Rruga A. Vokshi	10,265,280.00	0.00	0.00	0.00	10,265,280.00	0.00	0.00	0.00	10,265,280.00	Punimet kane perfunduar	-
Permiresimi i infrastruktures rrugore ne qytet (Përmirësimi i ndriçimit,vendosje tabela sinjalistike për rrugët me një kalim dhe sistemim asfaltim)	47,946,215.00	0.00	26,693,260.00	26,693,260.00	21,252,955.00	0.00	0.00	0.00	47,946,215.00	Punimet kane perfunduar	-
Mbikqyrje punimesh për ndërtimin e kompleksit multifunks zona sportive	2,024,205.00								0.00		2,024,205.00
Rikonstruksion i Teatrit "A.Z. Çajupi"	11,774,900.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	11,774,900.00	0.00	11,774,900.00	Punimet kane perfunduar	-
Shpronësime me interes publik	104,682,660.00	0.00	0.00	0.00	68,481,765.00	31,847,852.00	885,493.00	245,866.00	101,215,110.00		3,467,550.00
Total	199,000,000.00	22,306,740.00	26,693,260.00	49,000,000.00	100,000,000.00	31,847,852.00	12,660,393.00	245,866.00	193,508,245.00		5,491,755.00



BASHKIA KORÇË

CEB

Transhi I	2014-2023 shuma e disbursuar është 340,214 euro.
Transhi II	2016-2025 shuma e disbursuar është 640,000 euro.
Transhi III	2017-2026 shuma e disbursuar është 110,000 euro.
Transhi IV	2018-2027 shuma e disbursuar është 101,386 euro.

Sipas planit të pagesave të transhit të parë për periudhën dhjetor 2014- shtator 2017 janë paguar principal në vlerën 14,206,448 lekë.

Sipas planit të pagesave të transhit të dytë për periudhën shtator 2016- shtator 2017 janë paguar principal në vlerën 17,689,600 lekë.

Sipas planit të pagesave të transhit të tretë për periudhën korrik 2017- shtator 2017 janë paguar principal në vlerën 1,489,400 lekë.

Kjo hua është përdorur për ndërtimin e banesave me qëllim social.

9. Shërbimet publike

9.1.Shërbimi i pastrimit të qytetit

Shërbimi i pastrimit është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në shërbim të komunitetit. Ky shërbim do të kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të treta brenda qytetit, si dhe për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të fshatrave. Në buxhetin e vitit 2018, vlera e llogaritur për tu tenderuar për këtë shërbim është **85,643 mijë lekë**. Objekti i këtij shërbimi është pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korcës dhe transportimi i tyre për në landfillin rajonal, lagia e rrugëve, evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve, etj. Pastrimi i rrugëve bëhet çdo ditë prej orës 24:00 deri 06:00. Pastrohen çdo ditë 503.841 m² rrugë dhe trotuare. Transporti i mbeturinave për në landfill bëhet çdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03:00 deri 07:00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07:00 deri 11:00 nëpër lagjet që nuk kanë konteniere. Çdo ditë do evadohen rreth 85 ton mbeturina duke përfshirë qytetin edhe fshatrat. Nga projekti pilot që është filluar në pesë lagje të qytetit prej disa muaj, kemi arritur të reduktojmë sasinë e mbetjeve. Kontrata e re



BASHKIA KORÇË

parashikon që projekti të jetë i shtrirë në të gjithë Bashkinë e Korçës. Për këtë arsye do vendosen 100 kazanë jeshilë në qytet dhe 50 nëpër fshatra. Lagia e rrugëve bëhet për periudhën 01.04 deri 31.10 çdo ditë nga ora 06:00 deri 18:00 në një sipërfaqe prej 376.416 m², si dhe larje speciale e rrugëve me sip. 88.489 m² çdo ditë. Grumbullimi i mbeturinave bëhet me rreth 450 kontenierë në qytet dhe 150 konteniere në fshat, që do të evadohen tre herë në javë. Me fillimin e depozitimit të mbetjeve në landfill sipas projektit do të kemi dhe kosto shtesë prej 558.450 euro (duke përfshirë TVSH) për funksionimin e landfillit. Fondi i planifikuar për paga për supervisorin e pastrimit për vitin 2018 do të jetë në vlerën **540 mijë lekë** dhe fondi i planifikuar për sigurime shoqërore do të jetë në vlerën **90 mijë lekë**.

9.2. Shërbimi i transportit qytetës

Ky shërbim kryhet nga shoqëria “Ortakëria Korça”, së cilës i jepet kësaj shoqërie në formë subvencioni duke u bazuar në kontratën e lidhur me këtë shoqëri. Në buxhetin e vitit 2018 ky shërbim do të planifikohet në vlerën **10.000 mijë lekë**. Shërbimi i transportit qytetës mbështetet në realizimin e zërave të mëposhtëm:

- a) Itenerari i përcaktuar në kontratë i mjeteve.
- b) Orari i shërbimit të këtij transporti.
- c) Numri i mjeteve në linjë.
- d) Fluksi i kalimit të autobusëve nëpër stacionet e përcaktuara.
- e) Qëndrimi i mjeteve nëpër stacionet e përcaktuara.

Subjekti “Ortakëria” zbaton dhe nenin 3 të kontratës mbi udhëtimin falas të qytetarëve të moshës së tretë dhe ofrimin me gjysëm çmimi të biletës për studentët.

9.3. Mirëmbajtja e varrezave publike dhe ato të dëshmorëve

Për nevoja të bashkisë u investua në një sipërfaqe prej 30.000 m² ku u krijua një shtesë në varrezat publike. Kontrata e shërbimit aktual ka afat deri në korrik 2018. Për arsye të mirëmbajtjes së varrezave të reja, nga muaji gusht 2018 shërbimi do të rritet me një vlerë të shtuar. Vlera e këtij shërbimi do të jetë **4,500 mijë lekë**. Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm:



BASHKIA KORÇË

- a. Pastrim parcelash , rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit.
- b. Mirëmbajtje drurë dhe shkurre dekorative.
- c. Mbjellje drurë dekorative.
- d. Mirëmbajtje dhe krijim gardhe të gjelbërt me ligustër dhe lavandine.
- e. Kositje, grumbullim dhe transport bari.
- f. Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme.
- g. Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve.
- h. Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve.
- i. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve.
- j. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi.
- k. Mirëmbajtje e murit rrethues.
- l. Konsumi i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve.

- **Kontributi për Qarkun**

Duke u bazuar në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 38 “Burimet e financimit të Qarkut”, pika 3 ku shprehimisht thuhet: “Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së Bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të Bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Qarkut përcaktohet me vendim të Këshillit Bashkiak”, si dhe në udhëzimin nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, kuota për kontributin e Qarkut për vitin 2018 do të jetë **1,000 mijë lekë**.

- **Emergjenca civile**

Fondi i emergjencave civile, në zbatim të ligjit 8756 dt. 26.03.2002 “Për emergjencat civile” neni 16, pika 2, gërma ç), është planifikuar si zë i vecantë në vlerën **3,000 mijë lekë**. Ky fond është parashikuar të përdoret për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, duke përfshirë edhe dëmshpërblimin e familjeve, banesat e të cilëve dëmtohen nga fatkeqësi të ndryshme.



BASHKIA KORÇË

- **Fondi rezervë dhe ai i kontingjencës**

Fondi rezervë dhe ai i kontingjencës krijohen në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të udhëzimit nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” për të përballuar shpenzimet e paparashikuara në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore. Ky fond do të jetë për vitin 2018 në vlerën **2,000 mijë lekë**, nga të cilat 1,000 mijë lekë fondi rezervë dhe 1,000 mijë lekë fondi i kontingjencës. Ky fond duhet të jetë jo më shumë se 3% të totalit të shpenzimeve të miratuara. Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Kurse fondi i kontingjencës përdoret sipas përcaktimit në ligjin e buxhetit vjetor, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese.

10. Transfertat 2018

Fondi për transfertat tek institucione apo organizata të ndryshme për vitin 2018 do të jetë në vlerën **169,352 mijë lekë**:

- ✓ Kontributi i Bashkisë për shoqërinë Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë (KRWM) sh.a. për vitin 2018 do të jetë në vlerën **74,280 mijë lekë**.
- ✓ Kontributi i Bashkisë për UKKO do të jetë në vlerën **5,000 mijë lekë**, sipas kontratës me objekt: “Mbështetje financiare për sha Ujësjiellës Kanalizime Korçë, nga Bashkia Korçë, data 4.2.2010”
- ✓ Pagesa e transfertës për mbledhjen e tarifës së parkimit ndaj shoqërisë Alben 2 Security do të jetë në vlerën **14,000 mijë lekë**. Bashkia Korçë ka lidhur një kontratë me shoqërinë “Alben 2 Security” sh.p.k si agjent tatimor për mbledhjen e të ardhurave nga parkimi me pagesë në rrugë. Këto të ardhura do të ndahen 32% për Bashkinë Korçë dhe 68% për shoqërinë Alben 2 Security.
- ✓ Pagesa e komisionit për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël do të jetë në vlerën **150 mijë lekë** sipas udhëzimit nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.
- ✓ Kontributi financiar i Bashkisë për Shoqatën e Bashkive do të jetë në vlerën **1,290 mijë lekë**.
- ✓ Transferta për shoqatën BID do të jetë në vlerën **2,500 mijë lekë**.
- ✓ Kontributi i Bashkisë për Klubin e Futbollit do të jetë në vlerën **17,607 mijë lekë**.



BASHKIA KORÇË

- ✓ Kontributi i Bashkisë për mirëmbajtjen e sistemit “Transporti inteligjent” do të jetë në vlerën **2,525 mijë lekë** sipas VKB nr. 81 datë 9.9.2016 “Për miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për mirëmbajtjen e sistemit “Transporti inteligjent”.
- ✓ Transfertë për kompleksin Multifunksional Sportivo-Kulturor do të jetë në vlerën **25,000 mijë lekë**.
- ✓ Transferta për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e terreneve sportive do të jetë në vlerën **27,000 mijë lekë**.

10.1. Transfertat tek organizatat

Tabela 62: Detajimi i transfertës tek organizatat (000/lekë)

	TRANSFERTA TEK ORGANIZATAT	Fakt'16	Det.16	PL. 17	Pl. 17 nd	Fakt 10m	Pl pr 2017	Pl 18	P118-Plnd17+Det16
1.	AGJENTI TATIMOR ALBEN 2 SECURITY	9,464	614	14,280	14,180	6,666	11,080	14,000	(794)
2.	TRANSFERTË PËR UKKO	5,000		5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	-
3.	KONTRIBUT I BASHKISË PËR KRWM	4,000		30,031	30,031	7,000	7,000	74,280	44,249
4.	TRANSFERTA PËR SHOQATËN BID	2,116		2,500	2,500	2,105	2,500	2,500	-
5.	KONTRIBUT UJËSJELLËS FSHAT	229							-
6.	TAKSA TATIME DETYRIME NDAJ SHITIT	1							-
7.	KONTRIBUTI I BASHKISË PËR MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT "TRANSPORTI INTELIGJENT"			2,525	2,525			2,525	-
8.	KOMISION PËR TATIMIN E THJESHTUAR TË BIZNESIT TË VOGËL	116	6	200	200	66	80	150	(56)
9.	KONTRIBUTI PËR SHOQATËN E BASHKIVE	1,290		1,290	1,290	1,290	1,290	1,290	-
10.	KONTRIBUTI FINANCIAR PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT PUNIME PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT TË SHËTTITORES FAN NOLI DHE KOMPLETIMI I SISTEMIT TË NDRIÇIMIT TË UNAZËS SË QYTETIT	14,089		41,700	41,700	30,000	32,029		(41,700)
11.	KONTRIBUTI I BASHKISË PËR AEROPORTIN		700						(700)
12.	TRANSFERTË PËR KOMPLEKSIN MULTIF. SPORT.KULTUROR							25,000	25,000
13.	TRANSFERTË PËR MIRËMBAJTJEN DHE RUAJTJEN E TERRENEVE SPORTIVE							27,000	27,000
14.	KONTRIBUTI I BASHKISË PËR FUTBOLLIN SH.A.			14,247	-			17,607	17,607
15.	KONTRIBUTI FINANCIAR I BASHKISË PËR PAGESËN E TVSH PËR PROJEKTIN ZHVILLIMI I PRODUKTIT TURISTIK PËR GOSTIVARIN			610	710	700	700		(710)
16.	KONTRIBUT FINANCIAR I BASHKISË PËR PAGESËN E TVSH	715							-
17.	KONTRIBUT FINANC PËR ZMADHIMIN E KAPIT SHOQ KORÇA INV.				200		200		(200)



BASHKIA KORÇË

TOTAL TRANSFERTA TEK ORGANIZATAT	37,020	1,320	112,383	98,336	52,827	59,879	169,352	69,696
---	---------------	--------------	----------------	---------------	---------------	---------------	----------------	---------------

10.2. Transferta tek individët

Transfertat tek individët (ndihmë për qytetarët në nevojë) për vitin 2018 do të jetë në vlerën **200 mijë lekë**. Përdorimi i këtij fondi do të bëhet me urdhër të Kryetarit.

